



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1354, datë. 06.08. 2010

Për

“Mbylljen e procedimit administrative mbi zgjidhjen e mosmarreshjes se interkoneksionit te filluar me VKD nr. 1295, date 11.06.2010, midis sipermarresve Neofone sh.p.k, UNIFI Holdings dhe Albanian Mobile Communications sh.a.”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Anilda Mulgeci, në mbledhjen e datës 06.08. 2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

- Mbylljen e procedimit administrative mbi zgjidhjen e mosmarreshjes se interkoneksionit te filluar me VKD nr. 1295, date 11.06.2010, midis sipermarresve Neofone sh.p.k, UNIFI Holdings dhe Albanian Mobile Communications sh.a. te shoqeruar nga:
- Raport permbledhes (**Raporti**);
- Projekt Vendim i KD (**projektakti**);
- Dokumentet shkresore te paleve (**Provat, pretendimet**):

BAZA LIGJORE :

1. Neni 120, i Ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”;
2. Nenet 66-104 e vijues te ligjit nr. 8485, date 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (K.Pr.A);
3. Rregullore “Per procedurat e zgjidhjes se mosmarveshjeve”, miratuar me Vendim te Keshillit Drejtues te AKEP nr. 1296, date 11.06.2010;
4. Rregullore “Per Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar me VKD nr. 416, date 07.12.2007, e zevendesuar me Rregulloren e miratuar me VKD nr. 1300, date 14.06.2010;
5. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP (Rregullorja e Brendshme), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24.04.2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;
6. VKD nr. 1210 date 31.03.2010 “Per deklarimin OFNT te AMC sh.a”, i ndryshuar;
7. VKD nr. 629 date 10.02.2009 “Per miratimin e ofertes reference te interkoneksionit te AMC sh.a”;

K Ë SHILLI DREJTUES:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, te perbere nga:

1. Shkresa nr. 29 prot, date 18.05.2010 e Neofone sh.p.k “Ankim administrativ per moslidhjen e Marveshjes Interkoneksionit nga AMC sh.a” drejtuar AKEP, ne te cilen parashtron ne menyre te detajuar te gjithe korrespondencen shkresore si dhe pretendimet e saj;
2. Sipermarresi UNIFI Holdings me shkresen nr. 2420 prot, date 07.06.2010 i eshte drejtuar AKEP “Per zgjidhjen e mosmarveshjes me AMC per moslidhjen e marveshjes se interkoneksionit;
3. AKEP me shkresen nr. 1177 prot, date 05.04.2010 i drejtohet AMC dhe per dijeni Neofone qe te paraqese me shkrim sqarime ne lidhje me ankesen e Neofone sh.p.k;
4. Vendim i Keshillit Drejtues nr. 1295, date 11.06.2010 “Per fillimin e procedimit administrativ per zgjidhje mosmarveshje interkoneksioni midis sipermarresve Neofone sh.p.k, UNIFI Holdings dhe Albanian Mobile Communications sh.a.”
5. Shkrese e Neofone sh.p.k nr. 32 prot, date 23.06.2010 mbi “Prashtrimet perfundimtare per moslidhjen e marveshejs se interkoneksionit nga AMC sh.a ne zbatim te vendimit te Keshillit Drejtues te AKEP nr. 1295 date 11.06.2010”;
6. Shkrese e AMC sh.a nr. 3378/1 prot, date 06.07.2010 (AKEP: nr. 2432/4 prot, date 06.07.2010) “Pergjigje mbi kerkesen e vendimit nr.1295 mbi fillimin e procedimit administrativ per sipermarresit Neofone dhe Unifi”;

8. Projektvendim i KD te AKEP “Për mbylljen e procedimit administrative per zgjidhje mosmarreshje interkoneksioni te filluar me VKD nr.1295, date 11.06.2010 midis sipermarresve Neofone sh.p.k, UNIFI Holdings dhe Albanian Mobile Communications sh.a.” (**Projektvendimi**);
9. Raport permbledhes mbi projektvendimin (**Raport**);
si dhe,
10. Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen;
11. Bazës ligjore të sipërcituar;

V Ë R E N:

- AKEP, bazuar ne ankesen e sipermarresit Neofone sh.p.k me Vendimin e Keshillit Drejtues nr. 1295, date 11.06.2010 vendosi per fillimin e procedimit administrativ per zgjidhje mosmarreshje interkoneksioni midis sipermarresve Neofone sh.p.k, UNIFI Holdings dhe Albanian Mobile Communications sh.a;
- Ne vijim te VKD nr.1295, date 11.06.2010, nga pretendimet me shkrim te depozituara ne AKEP, vihet re se:
 - A. ***Sipermarresi Neofome sh.p.k me shkresen nr. 32 prot, date 23.06.2010 (AKEP: nr. 2432/3 prot, date 23.06.2010) “Parashtrimet perfundimtare per moslidhjen e marresheshejs se interkoneksionit nga AMC sh.a ne zbatim te vendimit te Keshillit Drejtues te AKEP nr. 1295 date 11.06.2010” sqaron se:***
 - 1 Me shkresen nr. 3 prot, date 15.10.2010, i ka kerkuar AMC lidhjen e MI per ofrimin e sherbimit te tranzitimit te thirrjeve telefonike kombetare dhe nderkombetare ne zbatim te ligjit nr. 9918, rregullores “Per Akses dhe interkoneksion” dhe ne RIO-n e sipermarresit AMC;
 2. AMC sh.a me shkresen nr. 5822/1 prot, date 14.01.2010 “Ne lidhje me nenshkrimin e Marresheshejs se Interkoneksionit”, ka kerkuar informacion te detajuar sipas pikes 4.1.2 te RIO-s, duke njoftuar Neofone se per momentin nuk ka mundesi teknike te ofroje kapacitete teknike si rrjedhoje e nje kapaciteteve te kufizuara per shak te nje upgrade te gjere te paisjeve switch-e i cili parashikohet te zgjase disa muaj;
 3. Neofone me shkresen nr.20 prot, date 11.03.2010 drejtuar AMC dhe per dijeni AKEP, i paraqet AMC te gjitha informacionet e kerkuara.
 4. Neofone me shkresen nr. 22 prot, date 23.03.2010 i eshte drejtuar AKEP per zgjidhje te mosmarreshjes.
 5. AKEP me shkresen nr. 1177 prot, date 05.04.2010 i drejtohet AMC dhe per dijeni Neofone ne zbatim te kompetencave te AKEP per zgjidhje mosmarreshje interkoneksioni sipas nenit 120 te ligjit nr. 9918, te paraqese me shkrim sqarime ne lidhje me ankesen e Neofone;
 6. Per sa me siper Neofone nuk eshte vene ne dijeni per nje pergjigje nga AMC pas kerkeses se AKEP per sqarime mbi ankesen e Neofone;
 7. **Neofone konsideron se:**
 - AMC ka tejkualuar afatin ligjor te percaktuar ne pikat 3.1 dhe 3.3 te RIO-s se saj per lidhjen e marresheshejs se interkoneksionit me Neofone;

- AMC nuk ka thirur asnjehere ne negociata Neofone;
- Vonesa e moslidhjes se MI me AMC, sipemarrsit Neofone i ka shkaktuar dem financiar te konsiderueshem.
- Pretendimet e AMC se nuk ka pasur mundesi teknike per t'u interkonektuar me Neofone jane te pverteta, te tejkaluara ne kohe dhe justifikime per moslidhjen e marreveshjes midis 2 paleve;
- AMC edhe pse kane kaluar 5 muaj qe nga kerkesa e Neofone per interkoneksion, nuk shprehet ende nese kane perfunduar upgrade te switch-eve;
- AMC pas shpalljes OFNT nuk asnje te drejte te shprehet se nuk ka kapacitete teknike per interkoneksion, pasi per AMC eshte detyrim ligjor te zbatoje te gjitha detyrimet ligjore pas shpalljes OFNT, detyrimet e RIO-s perfshire dhe paisjen me te gjitha kapacitetet teknike per te mundesuar interkoneksion me operatoret qe e kerkojne ate.
- Per sa me siper Neofone kerkon nga AKEP qe te dale sa me shpejt me Vendim ku te detyroje AMC te lidhe marreveshjen e interkoneksionit me Neofone sh.p.k, brenda nje afati disa ditor.
- Me shkresen nr. 29 prot, date 18.05.2010 (Nr. 2272 prot, date 18.05.2010 referenca e AKEP), ndermjet et jerave thekson se AMC ka lidhur MI me operatore te tjere gjate kohes qe Neofone ka qene ne pritje te mbarimit te modifikimive te rrjetit AMC (arsyeja e AMC per te mos dhene interkoneksion Neofone)

B. Sipermarrsi AMC sh.a me shkresen nr. 3378/1 prot, date 06.07.2010 (AKEP: nr. 2432/4 prot, date 06.07.2010) "Pergjigje mbi kerkesen e vendimit nr.1295 mbi fillimin e procedimit administrativ per sipemarrsit Neofone dhe Unifi" sqaron se:

1. Neofone ka shprehur kerkesen e tij per akses interkoneksion me AMC;
2. AMC e ka konsideruar kerkesen e Neofone duke kerkuar informacion te metejshem ne perputhje me RIO, ne menyre qe te projektonte nje zgjidhje teknike optimale per mundesine e interkoneksionit midis dy rrjeteve. Nderkohe e ka informuar Neofone se nuk ka mundesi teknike per te ofruar kapacitete duke shpjeguar se kjo situatë eshte krijuar si rrjedhoje e kapaciteteve dhe hapsirave te kufizuara me dhomen e swich-eve apo problemet me hapsirat per kabllot e fibrave optike te cilat nuk kane me vend per kablo te reja;
3. AMC thekson se kapacitetet e kufizura jane krijuar per shkak edhe te nje upgrade te gjere te swich-ve te AMC i cili eshte i domosdoshem per 2 arsye:
 - a. Centralet e AMC (MSC-s) jane ne operim qe prej vitit 2000, pra i perkasin nje teknologjie te vjeteruar dhe kane aritur ne saturim nga pikpamja e kapaciteteve duke lejuar interkoneksion vetem en nivele E1 dhe jo STM1, fiber etj;
 - b. Meqenese jemi para zhvillimeve te reja sic jane Portabiliteti i numrit dhe 3G, ky upgrade behet akoma me i domosdoshem per te pergatitur infrastrukturen e rrjetit te AMC, per te qene te gatshem qe te suportojte teknologjite e reja;
4. Nderkohe eshte punuar qe Neofone te lidhet me AMC nepermjet Altelecom sh.a, e cila eshte realizuar me date 24.02.2010 per thirrjet hyrese ne AMC dhe me date 02.03.2010 per thirrjet dalese.
5. Trafiku i ndersjellte midis 2 sipemarrsesve gjate 3 muajve eshte pothuajse zero konkretisht:

- a. Ne muajin Mars 2010 (25 min hyrese dhe 1 min dalese);
- b. Ne muajin Maj 2010 (1 min hyrese dhe 0 min dalese);
- c. Ne muajin Qershor 2010 (5 min hyrese dhe 0 min dalese),

edhe pse AMC ka implementuar ne sistem nje numer te konsiderueshem prefiksesh te autorizuara per Neofone, duke shpenzuar mjaft kohe ne konfigurim dhe duke alokuar resource ne swich-e.

6. *Ne lidhje me ankesen e sipermarresit Unifi, AMC shpjegon se:*

- Me sipermarresin Unifi ka lidhur nje kontrate si *carrier* nderkombetar, disa vite me pare, ne te njejten kohe Unifi ka krijuar nje kompani lokale dhe kerkon interkoneksion me termat me te cilet trajtohen operatoret lokale.
- *AMC thekson se Unifi ka detyrime financiare te pashlyera kundrejt AMC, te cilat konsideron se duhet te shlyhen dhe me pas te shikohet mundesia e plotesimit te kerkeses se Unifi sipas termave te rregullores se Akses Interkoneksionit dhe RIO.*

III Ne perfundim per sa me siper :

AMC v Neofone

-AMC ka justifikuar mos-lidhjen e marrveshjes se interkonkesionit me Neofone per shkak te pamundesise teknike per lidhje direkte, duke njoftuar njekohesisht se eshte punuar qe Neofone te lidhet me AMC nepermjet Albtelecom sh.a, lidhje e cila eshte realizuar me date 24.02.2010 per thirrjet hyrese ne AMC dhe me date 02.03.2010 per thirrjet dalese.

- Operatori ofrues i interkoneksionit (ne kete rast AMC) nuk mund te detyrohet te ofroje akses per interkoneksion kur nuk ekzistojne mundesite teknike. Megjithate, ne baze te pikes 4, seksioni I, kreu IV i Rregullores se Aksesit dhe Interkoneksionit miratuar nga ERT me VKD nr.416 date 7.12.2007 (ne fuqi ne kohen e mosmarrveshjes) dhe pikes 4 te nenit 6¹ te Rregullores se Aksesit dhe Interkoneksionit miratuar nga AKEP me VKD nr.1300 date 14.06.2010 (ne fuqi prej dates 10.07.2010²):

- *Operatori ofrues, në rastet kur refuzon t'i sigurojë operatorit përfitues shërbimet e specifikuara në ofertën referencë dhe e motivon këtë refuzim me mungesën e mundësive teknike, ai ka detyrimin t'i paraqesë operatorit përfitues një shpjegim gjithëpërfshirës të arsyeve të refuzimit dhe të specifikojë afatin kohor të saktë në të cilin kërkesa do të përmbushet. Kur operatori ofrues refuzon të sigurojë shërbimet e specifikuara në ofertën referencë për operatorin përfitues për shkak të kriterëve të tjera të përmendura në pikën 2 të këtij neni, operatori ofrues duhet, gjithashtu, të specifikojë kushtet që duhet të plotësojë operatori përfitues me qëllim që operatori ofrues të jetë në gjendje të përmbushë kërkesën. Për secilin rast të specifikuar në këtë paragraf, kur operatori ofrues paraqet shpjegime për operatorin përfitues, kopje të këtyre shpjegimeve i depozitohen njëkohësisht dhe AKEP-it.*

¹ Permbajtja e te percaktimeve ne ted y rregulloret, sipas referncave te dhena) eshte e njejte. Me siper eshet dhene percaktimi I rregullores aktuale te interkoneksionit.

² Rregulloraj eshte publikuar me 24.06.2010 dhesiaps nenit 18 te rregullores, ajo hyn ne fuqi 15 dite pas publikimit te saj ne faqen e Internetit te AKEP.

- Edhe ne rast te vertetimit te pamundesise teknike te AMC, shpjegimi i dhene nuk ka perfshire afatin kohor te sakte se kur mund te permbushet kerkesa.

- Per sa me siper rezulton se:

- AMC nuk ka dhene afat kohor te sakte se kur do te jete mundur realizimi i interkoneksionit direkt/perfundimi i punimeve ne rrjet, cka eshte ne kundërshtim me rregulloren e Akses dhe Interkoneksionit (te re dhe te meparshme);

- interkoneksioni midis AMC dhe Neofone eshte realizuar nepermjet Albtelcom, pra te dy rrjetet jane interkonektuar ne menyre indirekte duke perdorur sherbimet e tranzitimit te Albtelcom d.m.th eshte realizuar interkonektimi i rrjeteve. MI Albtelcom-Neofone eshte depozituar ne AKEP nga Albtelcom dhe ka referencen e Albtelcom nr.423 Prot, date 21.01.2010. (Neofone kerkon interkoneksion me AMC per terminim te thirrjeve hyrese nderkombetare)

- AKEP, bazuar ne kapacitetet teknike, menaxheriale dhe ekonomike te AMC, gjykon si te te arsyeshme lidhjen e MI midis AMC dhe Neofone brenda nje muaji nga datat e publikimit te vendimit ne faqen e Internetit te AKEP.

AMC v UNIFI

- AMC ka justifikuar mos-lidhjen e MI me UNIFI me detyrimet financiare te pashlyera kundrejt AMC nga UNIFI ne marredheniet e meparshme qe kjo kompani ka pasur si carrier nderkombetar me AMC. AMC konsideron se keto detyrime duhet te shlyhen dhe me pas te shikohet mundesia e plotesimit te kerkeses se Unifi sipas termave te rregullores se Akses Interkoneksionit dhe RIO.

- Bazuar ne piken 3.2 te nenit 9 te Rregullores se Aksesit dhe Interkoneksionit:

Nje operator terminues nuk duhet te bllokoje trafikun hyres nga nje operator tranzitues per shkak te nje mosmarrveshje me nje operator origjinues me te cilin nuk eshte i lidhur drejtperdrejt, me perjashtim te ratsit kur operatori origjinues ka borxhe te pashlyera ndaj operatarit terminues ne baze te njemarrveshjeje te meparshme interkoneksioni. Ne keto raste operatori terminues ka te drejte te bllokoje vetem trafikun hyres te origjinuar nga serite numerike te operatorit origjinues.

- Sipas interpretimit te ketij percaktimi, AMC ka te drejte te refuzoje lidhjen e MI per shkak te borxheve te pashlyera nga MI te meparshme.

- Sipas te dhenave te rregjistrimit te sipermarresve te dates 27.07.2010:

153	UNIFI HOLDINGS INC Dega në Shqipëri	1. Rrjet publik për transmetim të dhëna/internet; 2. Rrjet publik të telekomunikimeve; 3. Shërbimi publik telefonik fiks; 4. Shërbime të linjave me qera; 5. Shërbim publik për transmetim të dhëna/internet.	Ofrimi i rrjeteve ne pjesen e pare te vitit 2011 Ofrimi i sherbimeve ne pjesen e dyte te vitit 2011
-----	--	---	--

Pra UNIFI sipas te dhenave nuk do te filloje ofrimin e sherbimeve deri ne vitin 2011.

P Ë R K Ë T O A R S Y E :

Bazuar ne piken 1 te nenit 114 dhe piken 1 te nenit 115, te ligjit nr. 9918, nenin 140 e vijues te K.Pr.A, si dhe piken 17 te nenit 21 te Rregullores se Brendshme, Keshilli Mbikqyres.

V E N D O S :

1. Te mbylle procedimin administrative per zgjidhje mosmarreveshje interkoneksioni midis Neofone sh.p.k, UNIFI Holdings dhe Albanian Mobile Communications sh.a;
2. AMC te lidhe marreveshje interkoneksioni me Neofone sipas percaktimeve te Urdherit Bashkangjitur, brenda 30 diteve nga data e hyrjes ne fuqi te ketij vendimi.
3. UNIFI Holdings te filloje negocimin per lidhje te MI-se, me Albania Mobile Communications sh.a perpara dates se fillimit te ofrimit te sherbimit te njoftuar ne AKEP, dhe publikuar ne regjistrin e sipermarresve te dates 27.07.2010.
4. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit te AKEP: www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit te tij ne faqen e Internetit te AKEP.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURCE**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
Keshilli Drejtues

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ .08. 2010

U R D H E R
Nr.05, date 06.08.2010

Per

**“Lidhjen e Marreveshjes per Akses dhe Interkoneksion midis Albanian Mobile
Communications sh.a dhe Neofone sh.p.k”**

Ne mbeshtetje te nenit 60 te ligjit nr. 9918, date 19.05.2008 “Per komunikimet elektronike ne Republiken e Shqiperise”, Rregullore “Per procedurat e zgjidhjes se mosmarreveshjeve”, miratuar me Vendim te Keshillit Drejtues (VKD) te AKEP nr. 1296, date 11.06.2010, Rregullore “Per Aksesin dhe Interkoneksionin, miratuar me VKD nr. 1300, date 14.06.2010, VKD nr.1354, date 06.08.2010 “Mbylljen e procedimit administrative mbi zgjidhjen e mosmarreveshjes se interkoneksionit te filluar me VKD nr. 1295, date 11.06.2010 midis sipermarresve Neofone sh.p.k, UNIFI Holdings dhe Albanian Mobile Communications sh.a.”

U R D H E R O J :

1. Albanian Mobile Communications sh.a dhe Neofone sh.p.k te lidhin marreveshje interkoneksioni brenda 30 diteve nga data e hyrjes ne fuqi te ketij urdheri.
2. Marreveshja e Interkoneksionit te lidhet sipas percaktimeve te ofertes reference te interkoneksionit ne fuqi te Albanian Mobile Communications, dhe marreveshjeve te lidhura me palet e tjera.
3. Palet te depozitojne ne AKEP nje kopje te Marreveshjes te Interkoneksionit te nenshkruar nga palet brenda 15 diteve nga data e nenshkrimit.
4. Moszbatimi i ketij urdheri perben kundravajtje administrative dhe denohet me gjobe sipas parashikimeve te nenit 137 te ligjit nr. 9918 date 19.05.2008.

Ky urdher hyn në fuqi në datën e publikimit të tij në faqen e Internetit të AKEP.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:

4. Alketa MUKAVELATI

5. Benon PALOKA

6. Ibsen ELEZI

4. Zamira NURÇE